



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Adresa Rr. 13 Dhjetori, Nr 1 Shkodër,

web. www.bashkiashkoder.gov.al,

e-mail. keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al.

V E N D I M

Nr. 38, datë 30.5.2017

Për miratim shpërblimi për ekipet fituese në kampionate kombëtare për vitin sportiv 2016-2017

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.5.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 40, 54 shkronja "dh", 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", i ndryshuar, ligjin nr 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.Sh, të ndryshuar, ligjin nr 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, Udhwzimin e ministrit të financave nr 2, datë 6.2.2012 "Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, VKM nr 1720, datë 29.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar, VKB nr 8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e vitit 2017 të Bashkisë Shkodër", pas diskutimeve,

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit prej **500,000 lekë** (pesëqind mijë) si shpërblim për ekipin e volejbollit për meshkuj, kampion kombëtar, sipas listës emërore bashkëlidhur.
2. Burimi i financimit për fondin e mësipërm është buxheti 2017 i bashkisë Shkodër, përfshirë në programin P12, F1 O1 A11 "Shpërblim për ekipet kampion" të institucionit bashkia Shkodër në programin 8140 "Për sportin", zëri "transferime individuale".
3. Miratimin e fondit prej **560,000 lekë** (pesëqind e gjashtëdhjete mijë), si shpërblime të ndarë si më poshtë vijojnë:
 - a) Miratimin e fondit prej 110,000 lekë (njëqind e dhjetë mijë) si shpërblim për ekipin e atletikës, kampionët kombëtar, sipas listës bashkëngjitur.
 - b) Miratimin e fondit prej 120,000 lekë (njëqind e njëzet mijë), si shpërblim për ekipin e Xhudos kampionët kombëtar, sipas listës bashkëngjitur.
 - c) Miratimin e fondit prej 90,000 lekë (nëntëdhjetë mijë), si shpërblim për ekipin e Boksit, sipas listës bashkëngjitur.

- d) Miratimin e fondit prej 180,000 lekë (njëqind e tetëdhjetë mijë), si shpërblim për ekipin e futbollit të femrave, sipas listës bashkëngjitur.
 - e) Miratimin e fondit prej 20,000 lekë (njëzet mijë), si shpërblim për ekipin e Mundjes, sportisti Qamil Bajrami-kampion kombëtar.
 - f) Miratimin e fondit prej 20,000 lekë (njëzet mijë), si shpërblim për ekipin e çiklizmit, sportisti Bruno Kola-kampion kombëtar.
 - g) Miratimin e fondit prej 20,000 leke (njëzet mijë), si shpërblim për ekipin e gjimnastikës, sportiste Oneda Reçi-kampion kombëtar.
- 4. Burimi i financimit për fondin e mësipërm është fondi rezerve i bashkisë Shkodër,
 - 5. Institucionit Bashkia, në programin buxhetor 08140 "Zhvillimi i sportit" t'i shtohet kundërvlefta në lekë e fondit prej 560,000 lekë, shpenzime korente, artikulli 606 "transferta tek individë" për tu përdorur për ekipin e atletikës, ekipin e xhudos, ekipin e boksit, ekipin e futbollit të femrave, ekipin e mundjes, ekipin e çiklizmit, ekipin e gjimnastikës, sipas listave të sportistëve bashkëngjitur.
 - 6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 - 7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 30.5.2017

Shpallur në datën 31.5.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Pr. 9838 dt. 20.6.2017

Nr.655/1 Prot

Shkodër, me 14.06.2017

Lënda: Lidhur me vendimin nr. 38, datë 30.05.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të ligjit Nr.107/2016, dt 2.10.2016 "Për Prefektin", neni 8, germa a, në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 25, 40/4, 54-germa dh, neni 55/3, *ligjit nr.9376/2005 "Për sportin" i shfuqizuar tashmë me ligjin Nr.79/2017 "Për sportin", hyrë në fuqi me 5 Maj 2017, VKM Nr.1720 datë 29.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", i ndryshuar, analizoi vendimin nr.38, datë 30.05.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për miratim shpërblimit për ekipet fituese në kampionate kombetare për vitin sportive 2016-2017".*

Pas shqyrtimit, referuar VKM Nr.1720 datë 29.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", i ndryshuar, pika 1 e VKB për miratim fondi prej 500.000 lekësh si shpërblim për ekipin e volejbollit për meshkuj-kampion kombëtar është jo në përputhje me vlerën sipas tabelës III të VKM Nr.1720 datë 29.10.2008 akt nënligjor referues nga ju-(të rishqyrtohet shuma)

Pika 3, gërmat "b, c, d" të VKB kanë pasaktësi me relacionin bashkëlidhur vendimit, për shkak se diku citohet ekip fitues- diku individ fitues, (ka mospërputhje) duke krijuar konfuzion në trajtimin financiar sipas tabelës III të VKM nr.1720/2008 (trajtohen sipas niveleve të ndryshme), ndërsa janë të sakta pika 3-gërmat a, e, f, g.

Në respekt të autonomisë vendore për përdorim të fondeve, sjellim në vëmendje të tregoni kujdes në përdorim të fondit rezervë 2017 (për raste të paparashikuara në buxhet) meqë fondi i emergjencave civile është ezauruar.

Luftëmi merrni masa për rishqyrtim të vendimi: sipas ligjit të ri Nr.79/2017 "Për sportin", hyrë në fuqi me 5 Maj 2017.

Me respekt

